



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

## V E N D I M

Nr.157, datë 26.12.2019

### PËR

#### **MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2020-2022 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b”, pika 1.3 shkronja “c” nenit 41, pika 1, neni 54, shkronjat “ç” dhe “dh”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; ligjit nr.7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 6, shkronjat “ç” dhe “d”, nenit 33, pika 1, nenit 39, pika 1, nenit 40, nenit 41, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; nenit 5, shkronjat “a” dhe “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; neneve 6,15,17 dhe 32, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5 të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; pikës 17 të vendimit nr.165, datë 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njërive të vetëqeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civil dhe të punonjësve administrativë të njërive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 191, datë 05.04.2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 175, datë 08.03.2017, të Këshillit të Ministrave, për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar, të ndryshuar”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.715 datë 06.11.2019 “Për propozimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”; udhëzimit nr.7 datë 27.02.2019 të Ministrit të Ekonomisë dhe Financave “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2020-2022”; udhëzimit plotësues nr. 20 datë 10.07.2019 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për përgatitjen e Buxhetit Vendor”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

### V E N D O S I :

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2020-2022 si më poshtë vijon:
  - 1.1 Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2020-2022, është në shumat si më poshtë:

1.2 Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2020-2022, është në shumat si më poshtë:

Në lekë

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020, si më poshtë:
  - 2.1 Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrës Nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
  - 2.2 Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë së Tiranës sipas pasqyrës Nr.2 si dhe lidhjet e pagave nr.4, nr.18 dhe nr.24 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - 2.3 Të miratojë detajimin e shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrave Nr.3 dhe Nr.3/1 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
  - 2.4 Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve sipas Pasqyrës Nr.4 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
  - 2.5 Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2020.
3. Të miratojë Kalendarin e përgatitjes së PBA 2021-2023.
4. Task Forca e ngritur sipas vendimit nr.45, datë 06.07.2016 të Këshillit Bashkiak “Për ngritjen e task forcë-s për regjistrimin e asambleve të bashkëpronësisë dhe administratorëve të bashkëpronësisë”, i ndryshuar, vazhdon të funksionojë dhe të ushtrojë funksionin e saj edhe për një periudhë 1 (një) vjeçare, nga data 01 janar deri më 31 dhjetor 2020.
5. Kontratat me kohëzgjatje të caktuar për 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës të Aparatit të Bashkisë me pagë bruto 45,000 lekë/muaj miratohet edhe për një periudhë 12 mujore (01.01.2020-31.12.2020).
6. Kontratat me kohëzgjatje të caktuar për vitin 2020, për 50 (pesëdhjetë) punonjës me pagë bruto 30 000 lekë/muaj në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, miratohet për një afat 3 (tre) mujor dhe si rregull për periudhën Maj - Korrik, për mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes e kullimit, pas periudhës së shirave.
7. Të miratojë një ndryshim në pikën 8 të vendimit nr.38 datë 03.05.2019 “Për miratimin e nivelit të pagave të Njësive Administrative dhe Lagjeve të Bashkisë së Tiranës” duke shtuar 9 ndërlydhës me komunitetin për Lagjet nr.12,13,14, duke ndryshuar numrin e ndërlydhësve komunitarë nga 214 në 223.
8. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit Strategjik dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Përgjithshme për Marrëdhëniet me Publikun dhe Jashtë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Nja dhe Emergjencave Civile, Drejtoria Përgjithshme e Teknologjisë së Informacionit dhe Statistikave dhe Institucionet në varësi të Bashkisë së Tiranës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
9. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 Janar 2020.

KRYETAR

**TONI GOGU**